


PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE REKOMANDIMET PËR RAPORTIMIN E VETËVRASJEVE



MEDIA LUAN ROL TË RËNDËSISHËM NË PARANDALIMIN E VETËVRASJES

Mbi 100 studime në botë kanë gjetur se rreziku i "ngjitjes" qëndron dhe që raportimi i përgjegjshëm mund ta reduktojë rrezikun e vetëvrasjeve tjera.

Hulumtimi tregon se kohëzgjatja, frekuenca dhe rëndësia që jepet janë faktorët që ndikojnë më së shumti në rritjen e rrezikut për shpërndarjen e vetëvrasjes.

Mbulimi i kujdesshëm i vetëvrasjes mund të ndërrojë perceptimet, të zhdukë mitet dhe të informojë publikun mbi kompleksitetet e çështjes.

Raportimet e mediave mund të rezultojnë në kërkim të ndihmës kur ato përfshijnë burime të dobishme dhe mesazhe të shpresës dhe rikuperimit.

EVITONI...



Përshkrimin ose vizualizimin e metodës dhe vendit të vetëvrasjes.

Ndarjen e përmbajtjes së ndonjë shënimi para vetëvrasjes.

Përshkrimin e detajeve personale për personin i cili ka vdekur.

Prezantimin e vetëvrasjes si një përgjigje e zakonshme ose e pranueshme përballë vështirësive.

Tejthjeshtëzimin ose spekulimin mbi arsyen e vetëvrasjes.

Vendosjen e detajeve sensacionale në titull ose storie.

Glamorizimin apo romantizimin e vetëvrasjes.

Mbitheksimin e problemit të vetëvrasjes duke përdorur përshkrime si "epidemike" "shifra në qiell".

Vendosjen storiave të vdekjeve nga vetëvrasja në ballina në gazeta apo kryetituj të lajmeve.



NË VEND TË KËSAJ...



Raportoni vdekjen si vetëvrasje; mbajeni informacionin për vendin si të përgjithshëm.

Raportoni se një shënim është gjetur dhe është nën shqyrtim.

Mbajeni informacionin për personin në terma të përgjithshëm.

Raportoni që aftësitë mbrojtëse, mbështetja dhe trajtimi funksionojnë për shumicën e njerëzve që kanë mendime për vetëvrasje.

Përshkruani shenjat paralajmëuese për vetëvrasje dhe faktorët e rrezikshmërisë (p.sh. sëmundjet mendore, problemet në raporte) që i japin kontekst vetëvrasjes.

Raportoni mbi vdekjen duke përdorur faktet dhe gjuhën që janë të ndjeshme ndaj një familje që është duke vuajtur.

Ofroni kontekst dhe fakte për t'iu kundërvënë perceptimeve që vetëvrasja ka qenë e lidhur me heroizëm, nder ose besnikërisë ndaj një individi apo grupi.

Hulumtoni të dhënat më të besueshme në dispozicion dhe përdorni fjalë si "ngritje" ose "rritje".

Vendoseni artikullin diku brenda gazetës apo magazinës dhe tregojeni më vonë brenda lajmeve.

ORGANIZATAT PARTNERE:

Këto rekomandime janë vendosur duke e përdorur një model marrëveshjeje të përgjithshme të zhvilluar nga SAVE. Procesi është udhëhequr nga SAVE dhe ka përfshirë ekspertë/e kombëtarë/e dhe ndërkombëtarë/e për parandalimin e vetëvrasjes, shëndetin publik dhe komunikimit, organizatat e lajmeve, reporterë, shkolla të gazetarisë dhe ekspertë të sigurisë në internet. Organizatat bashkëpunëtoreshë përfshijnë: Shoqatën Amerikane të Hulumtimeve mbi Vetëvrasjen, Fondacioni Amerikan për Parandalimin e Vetëvrasjes, Shoqata Psikoanalitike Amerikane, Qendra e Annenbergut për Politika Publike, Redaktorët Menaxhues të Associated Press, Projekti Canterbury i Vetëvrasjes - Universiteti i Otagos, Christchurch, Zelandë e Re, Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, Linja me tekst për Kriza, Universiteti i Kolumbisë -Departamenti i Psikiatrisë, ConnectSafely.org, Shoqata Ndërkombëtare për Parandalimin e Vetëvrasjes, Task forca mbi median dhe vetëvrasjen, Universiteti i Mjekësisë së Vjenës, Aleanca Kombëtare për Sëmundjet Mendore, Instituti Kombëtar i Shëndetit Mendor, Shoqata Kombëtare e fotografëve gazetarë, Bashkëpunimi për Sigurinë në Internet, Linja Kombëtare për Parandalimin e Vetëvrasjes (në ShBA), Instituti Psikiatrik i New York-ut, Instituti Poyente, Administrata e Shërbimeve mbi Abuzimin me Substanca dhe Shëndetit Mendor, Zërat e Edukimit - Vetëdijësimi për Vetëvrasjen, Qendra Burimore për Parandalimin e Vetëvrasjes, Shendet emocional kumbues.



LISTA E TIK-EVE PËR RAPORTIM TË PËRGJEGJSHËM

Raportojeni vetëvrasjen si çështje të shëndetit publik. Përfshirja e storieve për shpresë, shërim dhe rikuperim mund ta ulë rrezikun e shpërndarjes së vetëvrasjes.

Përfshini burimet e informacionit. Ofroni informacione mbi shenjat që sinjalizojnë rrezik të vetëvrasjes si dhe informacione mbi linjat telefonike dhe trajtimet. Minimalisht, përfshini Linjën e Jetës (0800 12345).

Përdorni gjuhë të përshtatshme. Fraza dhe fjalë të caktuara si "bëri vetëvrasje" ose referimi i vetëvrasjes si "e suksesshme", "e pasuksesshme" ose "tentativë e dështuar" mund të stigmatizojnë edhe më tutje vetëvrasjen, të shpërndajnë mite dhe të shkojnë kundër objektivave për parandalimin e vetëvrasjes. Në vend të këtyre, përdorni "vdiq nga vetëvrasja" apo "e vrau vetën".

Theksoni ndihmën dhe shpresën. Stori e rikuperimit përmes kërkimit të ndihmës dhe aftësive mbrojtëse pozitive janë të fuqishme, veçanërisht kur ato vijnë nga njerëz të cilët kanë kaluar përmes rrezikut për vetëvrasje.

Pyesni ndonjë ekspert/e. Intervistoni ekspertë/e të parandalimit të vetëvrasjes ose të shëndetit mendor për t'i validuar faktet tuaja mbi rrezikun e vetëvrasjes dhe sëmundjeve mendore.

ÇKA TË BËHET

Mos e lini personin vetëm

Largoni çdo armë zjarri, alkool, droga ose objekte të mprehta që mund të përdoren për tentim vetëvrasjeje

Thirrni Linjën e Jetës (0800 12345)

Dërgojeni personin te një dhomë e emergjencës ose kërkoni ndihmë nga një profesionist/e mjekësor/e ose të shëndetit mendor.

SHENJAT QË SINJALIZOJNË VETËVRASJEN

Biseda për dëshirën për të vdekur

Kërkimi i ndonjë mënyre për ta vrarë vetën

Biseda për ndjesitë e të qenurit pa shpresë ose pa qëllim

Biseda për ndjesitë e të qenurit të bllokuar ose në një dhimbje të padurueshme

Biseda rreth të qenurit barrë për të tjerët

Rritja e përdorimit të alkoolit ose drogave

Sjellje ankicioze, të trazuara ose të pamatura

Mungesa e gjumit ose gjumi i tepërt

Tërheqja ose ndjenja e të qenurit i/e izoluar

Shfaqja e ndjenjës së tërbimit ose biseda rreth kërkimit të hakmarrjes

Shfaqja e ndryshimeve ekstreme të disponimit

RAPORTIMI NËN KUSHTE TË PAZAKONTA

Gjuajtje me armë në masë ku gjuajtësi/ja ia merr jetën vetës jetën është ndryshe nga një vetëvrasje e izoluar. Rekomandimet për raportimin e gjuajtjeve në masa mund të gjenden në: reportingonmassshootings.org.

Vetëvrasja pas vrasjes së një personi tjetër është gjithashtu ndryshe nga një vetëvrasje e izoluar. Rrethanat janë shpesh komplekse në këto incidente, siç janë edhe në rastet e vetëvrasjes. Për ta minimizuar frikën tek komuniteti, evitoni spekulimet mbi motivet dhe citoni fakte dhe deklarime që tregojnë që ngjarje të tilla janë të rralla. Tregoni ndjeshmëri për të mbijetuarit/at përgjatë intervistave dhe raportimeve tuaja. Theksoni hulumtime që tregojnë se shumica e kryerësve të veprave vrasje-vetëvrasje kanë shpesh probleme mendore ose probleme me përdorimin e substancave por rikujtojuuni lexuesve se shumica e njerëzve që përjetojnë probleme mendore janë jo të dhunshëm.